

Procesverbal- Tipi i kontratës - Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

Objekti i procedurës: “Blerje pajisje teknologjike dhe gjeodezike”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP): 38295000-9

Vlera e fondit limit: 2,497,667 (dymilion e katërqindnëntëdhjeteshtatë mijë e gjashtëqindgjashtëdhjeteshtatë) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 82 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 83 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori Ekonomik (OE) duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë licencë profesionale të kategorisë 8 të lëshuar nga organet kompetente, të vlefshme për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e gjeodezisë dhe hartografisë, e cila të përfshijë minimalisht këto nënkategori:

a) Rilevime inxhinierike

b) Rilevime inxhinierike kadastrale

c) Sisteme GIS

d) Bazamente gjeodezike

e) Projektim fotogrametrik dhe hartografik

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 77, pika 1/a të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) ku parashikohet se “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale” dhe nenin 40, pika 4/ a), të VKM nr.

285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ku parashikohet se: *“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore”*

Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë licencë profesionale të kategorisë 8 në fushën e gjeodezisë dhe hartografisë është e domosdoshme dhe proporcionale me objektin e prokurimit, i cili konsiston në furnizimin me pajisje teknologjike dhe gjeodezike.

Këto pajisje janë të një natyre teknike të avancuar dhe kërkojnë njohuri të specializuara për konfigurim dhe përdorim, përputhshmëri me standardet gjeodezike dhe kadastrale dhe integrim me sisteme ekzistuese të të dhënave hapësinore.

Rilevime inxhinierike: Siguron që OE ka kapacitetin teknik për përdorimin praktik të pajisjeve në terren dhe për verifikimin e saktësisë së tyre.

Rilevime inxhinierike kadastrale: E domosdoshme për përputhshmërinë me standardet e Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe përdorimin e të dhënave në regjistrat zyrtarë.

Sisteme GIS: Garanton aftësinë për integrimin e pajisjeve me sisteme të menaxhimit të informacionit hapësinor dhe përpunimin e të dhënave digjitale.

Bazamente gjeodezike: Siguron njohuri mbi rrjetet referuese dhe kalibrimin e pajisjeve në përputhje me sistemet koordinative kombëtare.

Projektim fotogrametrik dhe hartografik: E nevojshme për përdorimin e teknologjive moderne (p.sh. dronë, skanime) dhe për përpunimin korrekt të produkteve hartografike.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 OE duhet të paraqesë vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023 dhe 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: *“Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”*. Vendosija e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomikë ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomikë dhe financiarë për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët*

monetar...”. Në nenin 55 pika 4 të VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar është përcaktuar se: “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”.

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur të thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 19 % e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ku parashikohet se “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën” nenit 55, pika 4(b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se “Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55, pika 4, gërma (b) e VKM nr. 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke qënë se vlera e fondit limit është nën kufirin e ulët monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të kenë të punësuar, për muajin e fundit, minimumi 4 (katër) punonjës, si më poshtë:

- 3 (tre) ekspert në fushën e gjeodezi, hartografi, fotogrametri
- 1 (një) specialist IT

Për punonjësit e kërkuar më lart, duhet të paraqiten dokumentat:

- a. Për ekspertët në fushën e gjeodezi, hartografi, fotogrametri:
 - a. Diplomë me profil inxhinier gjeodezi/gjeofizike/gjeomatike (ose ekuivalente)
 - b. Kontratë pune (e vlefshme),
 - c. CV;
- b. Për specialistin në fushën IT duhet të paraqitet:
 - a. Kontrate pune përkatëse, (e vlefshme)
 - b. Diplomë/certifikim në shkenca kompjuterike ose ekuivalente

Operatori ekonomik të paraqesë deklaratë që stafi i deklaruar do të jetë i disponueshëm gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

Ky kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 77, pika 4, e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), nenin 40, pika 5/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) ku parashikohet se “5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”.

Tre ekspertët në gjeodezi, hartografi dhe fotogrametri janë të domosdoshëm për kryerjen e operacioneve komplekse në terren dhe në laborator, të cilat përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në, matjet gjeodezike precize me pajisje GPS gjeodezike dhe total station, krijimin dhe përpunimin e bazamenteve gjeodezike, realizimin e rlevimeve inxhinierike dhe kadastrale, si dhe prodhimin e hartave dhe materialeve fotogrametrike. Ekspertët sigurojnë që të dhënat e mbledhura të jenë të saktë, të harmonizuara me sistemet koordinative kombëtare dhe kadastrale, të përputhshme me standardet dhe rregulloret e Agjencia Shtetërore e Kadastrës, dhe të integruara në sisteme GIS për analizë, planifikim dhe menaxhim hapësinor.

Specialisti IT është po ashtu i domosdoshëm për menaxhimin e infrastrukturës digjitale të të dhënave, përpunimin dhe ruajtjen e informacionit, integrimin e pajisjeve gjeodezike me sistemet GIS dhe mbrojtjen e të dhënave kundër humbjes, manipulimit ose përdorimit të paautorizuar. Ky rol siguron që të gjitha të dhënat e mbledhura nga terreni dhe pajisjet teknologjike të jenë të përdorshme në kohë reale, të analizueshme, të sigurta dhe të besueshme gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

Kërkesa për dokumentacionin përkatës, duke përfshirë diplomën ose certifikimin e ekspertëve në gjeodezi, hartografi dhe fotogrametri, kontratat e punës të vlefshme dhe CV-të e stafit, garanton verifikimin e aftësive dhe eksperiencës së tyre. Për specialistin IT kërkohen diploma ose certifikime në shkenca kompjuterike ose fusha ekuivalente, dhe kontratë pune e vlefshme. Përveç kësaj, deklarata që stafi i deklaruar do të jetë i disponueshëm gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës siguron

angazhimin e vazhdueshëm të stafit dhe ruajtjen e kapaciteteve profesionale përgjatë implementimit të kontratës.

Ky kriter garanton që Operatorët Ekonomikë të kenë kapacitetin njerëzor dhe profesional për të përdorur, menaxhuar dhe integruar pajisjet teknologjike dhe gjeodezike në mënyrë të sigurt, të saktë dhe efikase.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të autorizuar/akredituara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë:

- *ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalente*
- *ISO 270001:2022 “Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit” ose ekuivalente*
- *ISO 20000-1:2018 “Sistemi i menaxhimit të shërbimeve të teknologjisë së informacionit” ose ekuivalente.*

Certifikimet e mësipërme duhet të jenë të jenë të vlefshme, si dhe duhet të plotësohen nga secili prej anëtarëve në rast të ofertës nga bashkim operatorësh.

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 77, pika 1/a dhe nenin 79, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 44, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Kërkesa që Operatorët Ekonomikë të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të autorizuar ose të akredituara, të vlefshme dhe në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht, garantin nivel të lartë të menaxhimit të cilësisë, sigurisë së informacionit dhe shërbimeve teknologjike në zbatimin e objektit të prokurimit për NSHP Himarë.

Certifikata ISO 9001:2015 – Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë vërteton se operatorët ekonomikë kanë vendosur, zbatojnë dhe mirëmbajnë një sistem të strukturuar për menaxhimin e cilësisë në të gjitha fazat e aktivitetit të tyre, duke përfshirë furnizimin, konfigurimin, instalimin dhe përdorimin e pajisjeve teknologjike dhe gjeodezike. Kjo certifikatë garanton që proceset janë të dokumentuara, të standardizuara dhe të kontrolluara, duke siguruar një nivel të qëndrueshëm të cilësisë, minimizimin e gabimeve teknike dhe përputhshmërinë me kërkesat ligjore dhe teknike të Shqipërisë.

Certifikata ISO 27001:2022 – Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit është e domosdoshme për garantimin e sigurisë së të dhënave të mbledhura gjatë përdorimit të pajisjeve gjeodezike dhe sistemeve GIS. Kjo certifikatë siguron që operatorët ekonomikë kanë krijuar politika dhe procedura për mbrojtjen e informacionit kundër humbjes, aksesit të paautorizuar dhe manipulimeve, duke garantuar integritetin dhe besueshmërinë e të dhënave hapësinore që do të përdoren për vendimmarrje dhe planifikim.

Certifikata ISO 20000-1:2018 – Sistemi i Menaxhimit të Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit vërteton aftësinë e operatorëve ekonomikë për të menaxhuar shërbimet IT të lidhura me pajisjet teknologjike dhe gjeodezike, duke përfshirë integrimin e sistemeve, mbështetjen teknike, monitorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve. Kjo certifikatë garanton që shërbimet e IT-së janë të strukturuar, të efektshme dhe të përshtatshme për mbështetjen e operacioneve teknike në terren dhe për përpunimin e të dhënave gjeohapësinore.

Përmbushja e këtij kriteri siguron që Operatorët Ekonomikë kanë vendosur sisteme të menaxhimit dhe kontrollit që i bëjnë të aftë për të siguruar saktësi, besueshmëri, siguri dhe përputhshmëri me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës. Në rast bashkimi operatorësh duhet të paraqiten nga secili pjesëmarrës për të garantuar që të gjithë ofruesit kanë kapacitet të barabartë.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostra për artikujt:

- 1- GPS
 - a. Bazë bashkë me certifikatat CE, NOA-NGS dhe FCC
 - b. Tableti
 - c. Softueri
 - d. zhaloni
- 2- Bipodi-dykëmbësh
- 3- Detektuesi metal/Gize

Mostrat do të paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor: Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë në datën dhe orën e hapjes së tenderit, me adresë: pranë stadiumit, Himarë.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe pikën 6/a, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: “6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;”.

Kërkesa që Operatorët Ekonomikë të paraqesin mostra për artikujt kryesorë të prokurimit, përfshirë Marrësin Gjeodezik GNSS Bazë dhe Rover së bashku me certifikatat CE, NOA-NGS dhe FCC, tabletin, softuerin dhe zhalonin, si dhe bipodin dhe detektuesin metal/gize, është e domosdoshme për të garantuar verifikimin e cilësisë reale dhe përputhshmërisë së pajisjeve me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentacionin e tenderit. Prezantimi i mostrave pranë Autoritetit Kontraktor, në datën dhe orën e hapjes së tenderit, siguron që komisioni vlerësues të ketë mundësinë për të

kontrolluar dhe vlerësuar fizikisht karakteristikat, performancën dhe funksionalitetin e pajisjeve, duke konfirmuar që ato përmbushin standardet e saktësisë, rezistencës, komunikimit dhe sigurisë të kërkuara. Ky proces garanton që Operatorët Ekonomikë nuk paraqesin vetëm specifikime teknike në letër, por ofrojnë produkte të verifikuara, të cilat mund të përdoren në mënyrë efektive për realizimin e operacioneve gjeodezike dhe teknologjike të NSHP Himarë. Në këtë mënyrë, kërkesa për mostrën është një masë e drejtë, e proporcionalitetit dhe e lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit, duke siguruar cilësi, besueshmëri dhe përputhshmëri me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Specifikimi i Materialeve:

1. Marrës Gjeodezik GNSS (Bazë – Rover)

a) Konfigurimi BAZË (GSM/UHF)

- Trupi kryesor prej aliazh magnezi, kapaku i sipërm prej ABS/PC
- Minimumi 1400 kanale
- Bateri e brendshme: minimum 13,000 mAh
- Saktësia e matjes statike: minimum 2.5 mm
- Radio UHF: minimum 5W
- Gjurmimi i satelitëve: GPS (L2, L2, L5), GLONASS (L1, L2, L5), BDS (B1I, B2I, B3I, B1C, B2a, B2b PPP), GALILEO (E1, E5a, E5b, E6 PPP), SBAS (L1 PPP)
- Komunikimet: 4G, Bluetooth, WiFi, Radio
- Saktësia e shpejtësisë (RMS): 0.03 m/s
- Sensor IMU: minimum 60°
- Rezistent ndaj temperaturave: -20°C deri +60°C
- Certifikime: CE, NOA-NGS, FCC

b) Konfigurimi ROVER (GSM/UHF)

- Trupi kryesor prej aliazh magnezi, kapaku i sipërm prej ABS/PC
- Minimumi 1400 kanale
- Bateri e brendshme: minimum 9,000 mAh
- Saktësia e matjes:
- Statik: $H \pm (2.5 \text{ mm} + 0.5 \text{ ppm})$, $V \pm (5 \text{ mm} + 0.5 \text{ ppm})$
- RTK: $H \pm (8 \text{ mm} + 1 \text{ ppm})$, $V \pm (15 \text{ mm} + 1 \text{ ppm})$
- Saktësia e kohës RMS: 20 ns
- Koha e rikapjes së sinjalit: 1 sekondë
- Gjurmimi i satelitëve dhe komunikimi si për bazën
- Saktësia e shpejtësisë (RMS): 0.03 m/s
- Sensor IMU: minimum $60^\circ \leq 2 \text{ cm}$
- Rezistent ndaj temperaturave: -20°C deri +60°C
- Peshë: më e vogël se 800 g
- Certifikime: CE, NOA-NGS, FCC

c) Tablet/Kontroller

- RAM/ROM: 8GB / 2586GB
- CPU: Octa Core, 2.4 GHz
- Ekran: minimum 8 inch, rezolucion 800×1200

- Sistem operativ: Android V13 ose ekuivalent
- Bateri: minimum 10,000 mAh
- Bluetooth 5.2, NFC 13.56 MHz
- Kamera: 8 MP (para), 16 MP (pas)
- GPS: BDS, GPS, GLONASS, Galileo
- Peshë: më e vogël se 1.2 kg

d) Softueri/Programi

- Përdorim në të gjitha regjimet GNSS: statik, stop & go, matje të shpejta
- Funksione minimale: rilevim pikash, rilevim i detajuar, CAD, piketim pikash dhe vijash, kontroll kuotash (DTM), linja elektrike, kalibrim CAD, përlllogaritje volumesh
- Mundësi import/export: DXF, AutoCAD, CSV, TXT, KML
- Integrim CAD për vizualizim të të dhënave
- Mjetet për konvertim koordinatash, këndesh, perimetri, sipërfaqe, volum
- Softueri në gjuhën shqipe

e) Zhalon/Stekë

- Material: fibër karboni
- Ndarje çdo 1 m, gjatësi totale 2 m

f) Kapsë kontrolleri

- Përshtatje për tabletin në zhalon

Operatori ekonomik duhet të paraqesë kataloget përkatës, për pikat a, b, c, d dhe e.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi për pajisjet GPS/GNSS Bazë Rover

Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikimin e prodhuesit për ekspertin që do të bëjë trajnimin për GPS/GNSS Bazë Rover

Operatori ekonomik duhet të paraqesë CE/NGS, FCC certifikatë për pajisjet GPS/GNSS Bazë Rover

Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë për garanci 1 vjeçare.

2. Total Station

a) Të dhënat teknike të përgjithshme

- Ekrane: jo më pak se $2 \times 5.5''$
- Sistem operativ: Android V11 ose ekuivalent
- Ndërfaqe: USB, Type-C, ËiFi, Bluetooth, 4G
- RAM ≥ 4 GB, ROM ≥ 64 GB
- Zmadhim: minimum 30×
- Sistemi lexues: Absolute Encoder
- Saktësia këndore: $\leq 2''$
- Distanca matjeje me laser: ≥ 1000 m
- Saktësi distancash: $\leq (2 \text{ mm} \pm 2 \text{ ppm})$
- Koha e matjes: Fine ≤ 0.5 s, Tracking ≤ 0.3 s
- Mbrojtje: IP55

b) Softueri

- Përfshin të gjitha funksionet: rilevim, piketim, gjeoreferim, llogaritje perimetri/sipërfaqe, Reference Line, CAD, DXF, ShapeFile
- Hartë online për sisteme koordinative të njohura

c) Seti aksesorësh

- 2 bateri, 1 treger jo optik, kablllo Type-C to USB OTG, MicroSD card, mbulesë nga shiu

Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogët përkatës, për pikat a,b.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi për pajisjen Instrument Total Station

Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikimin e prodhuesit për ekspertin që do të bëjë trajnimin për instrumentin Total Station.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë për garanci 1 vjeçare.

3. Set Droni me RTK

a) Karakteristikat

- Dron profesional industrial, platformë multirotor
- MTOW: ~4 kg, kohë fluturimi: deri 45 min, shpejtësi horizontale: ≤ 21 m/s, rezistencë erë: ≤ 12 m/s
- GNSS multi-band + modul RTK, saktësi pozicionimi ± 0.1 m H/V
- Kamera CMOS, rezolucion foto: deri 20 MP, video: 4K UHD
- Obturator mekanik, shmangie pengesash 360°
- Transmetim dual-band 2.4/5.8 GHz, distanca: ≤ 15 km
- Bateri inteligjente Li-ion

b) Adapter SIM celular

- Për dron

c) Softuer për përpunim të të dhënave

- Hartë 2D reale, rindërtim 2D/3D, multispektral, import KML, POS, planifikim misioni 3D, vendosje GCP

d) Seti i plotë

- 1 dron, modul RTK, 1 kontrollor, çantë transporti, 2 helika rezervë, 1 bateri, 1 stacion karikimi, 2 mbajtëse droni, aksesorë pastrami

Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogët përkatës, për pikat a, b, c.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratën e konformitetit (EU Declaration of Conformity).

Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë garanci 1 vjeçare.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë për ekspertin një certifikatë trajnimi programin e përpunimit të të dhënave

4. Set Prism dhe Miniprism

- Prism i madh offset 0 mm



- Prism i vogël



5. Trekëmbësh alumini me kokë rrethore

- Heavy Duty, alumini i përforcuar
- Kokë rrethore Ø166 mm, vidë qendrore bakri, Dual Lock
- Mekanizëm Self-Locking, stabilitet maksimal
- Përshtatshëm për stacione totale, GPS/GNSS, instrumente matëse



6. Adapter për GPS/GNSS

- Filetim standard 5/8"-11
- Sy optik për centërzim të saktë mbi pikën e matjes



7. Bipod

- Material: fibër karboni jashtë, tub alumini brenda
- Lartësi e rregullueshme
- I pajisur me çantë transporti



8. Detektues Metal/Gize

- Thellësia e detektimit: deri 90 cm
- Detekton: saracineska, tuba metalikë, kapak gize
- Mbrojtje: IP68
- Kontroll ndezjeje me buton
- Autonomi: deri 100 orë me një set baterish

9. Trajnimi i stafit

- a) GPS Bazë – Rover: 4 ditë
- b) Total Station: 4 ditë
- c) Dron: 4 ditë
- d) Detektues Metal/Gize: 1 ditë

Objektivat: Njohuri teorike dhe praktike për përdorim të saktë dhe efikas të pajisjeve.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë programin e trajnimit për pikën a, b, c dhe d.

Sasia e mallit që kërkohet:

1-	Marrës gjeodezik GNSS (bazë – rover)	copë 1 (një)
2-	Total station me import AutoCAD	copë 1 (një)
3-	Set droni RTK	copë 1 (një)
4-	Set miniprizm dhe prizm	copë 1 (një)
5-	Trekëmbësh alumini	copë 1 (një)
6-	Treger	copë 1 (një)
7-	Bipod	copë 1 (një)
8-	Detektues metal/gizë	copë 1 (një)
9-	Trajnim i stafit: (GPS bazë – rover: 4 ditë, total station: 4 ditë, dron: 4 ditë, detektues metal/gizë: 1 ditë)	

Afatet e lëvrimit: 10 (dhjetë) ditë kalendarike nga lidhja e kontratës.

Objekti i prokurimit përfshin furnizimin me pajisje teknologjike dhe gjeodezike të avancuara, të cilat kërkojnë kapacitete profesionale dhe teknike të larta nga Operatorët Ekonomikë. Pajisjet përfshijnë Marrës Gjeodezik GNSS Bazë–Rover, Total Station, set droni me RTK, prizm dhe miniprizm, trekëmbësh alumini me kokë rrethore, adapter për GPS/GNSS, bipod, detektues metal/gize, si dhe program trajnimi për stafin përkatës.

Marrësi Gjeodezik GNSS Bazë–Rover përmban konfigurime të detajuara për bazën dhe rover-in, të cilat përfshijnë trupin kryesor prej aliazh magnezi me kapak ABS/PC, një numër të konsiderueshëm kanalesh për gjurmimin e satelitëve GPS, GLONASS, BDS, GALILEO dhe SBAS, bateri të fuqishme për operim të pandërprerë në terren, radio UHF me fuqi të mjaftueshme, sensorë IMU për orientim të saktë dhe komunikim përmes 4G, Bluetooth, WiFi dhe radio. Saktësia e matjeve statike dhe RTK është e garantuar në kuota milimetrike, ndërsa pajisjet janë të dizajnuara për t'u përdorur në temperatura ekstreme nga -20°C deri +60°C dhe janë të certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare CE, NOA-NGS dhe FCC. Pajisjet shoqërohen me tablet/kontroller të fuqishëm me memorje të konsiderueshme, CPU Octa Core dhe ekran të madh për menaxhimin e matjeve, si dhe softuer të specializuar që mbulon të gjitha regjimet e GNSS, përfshirë rilevime statike, stop & go, matje të shpejta, CAD dhe përpunim të të dhënave, me mundësi importimi dhe eksportimi të formateve të ndryshme. Pajisjet përfshijnë gjithashtu zhalon prej fibrash karboni dhe kapele kontrolleri për përdorim praktik në terren. Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin katalogët përkatës, autorizimin e prodhuesit, certifikatat CE/NGS/FCC, certifikimin e trajnerit për ekspertin dhe deklaratë për garanci minimale një vjeçare.

Instrumenti Total Station është i dizajnuar për të ofruar saktësi të lartë këndore dhe lineare, me ekranet dhe ndërfaqet më të avancuara për menaxhimin e të dhënave, zmadhim minimal 30x, lexues Absolute Encoder, distancë matjeje me laser ≥ 1000 m dhe mbrojtje IP55. Softueri i bashkangjitur mundëson të gjitha funksionet e rilevimit, piktimit, gjeoreferimit, përlllogaritjeve të perimetrit dhe sipërfaqes, integrim me CAD dhe shfrytëzim të hartave online. Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin katalogët, autorizimin e prodhuesit, certifikimin e trajnerit dhe deklaratën e garancisë një vjeçare.

Seti i dronit profesional industrial me RTK ofron fluturim deri në 45 minuta, shpejtësi horizontale të kufizuar, rezistencë ndaj erës, GNSS multi-band me modul RTK dhe saktësi pozicionimi ± 0.1 m, kamera CMOS me rezolucion deri në 20 MP dhe video 4K UHD, obturator mekanik dhe sistem shmangie pengesash 360°, transmetim dual-band dhe bateri inteligjente Li-ion. Seti përfshin gjithashtu adapter SIM celular, softuer për përpunimin e të dhënave 2D/3D, import KML, planifikim misioni dhe vendosje GCP, si dhe çantë transporti dhe aksesore të nevojshëm. Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin katalogët, deklaratën e konformitetit (EU Declaration of Conformity), deklaratën e garancisë njëvjeçare dhe certifikimin e trajnerit për ekspertin që do të kryejë trajnimin. Pajisjet mbështetëse si prism dhe miniprism, trekëmbësh alumini me kokë rrethore, adapter GPS/GNSS dhe bipod janë të dizajnuara për stabilitet maksimal dhe përshtatje me instrumentet kryesore, duke garantuar saktësi të matjeve dhe përdorim praktik në terren. Detektuesi Metal/Gize ofron thellësi të detektimit deri në 90 cm, mbrojtje IP68 dhe autonomi deri në 100 orë me një set baterish.

Programi i trajnimit të stafit përfshin përdorimin teorik dhe praktik të të gjitha pajisjeve: 4 ditë për Marrës GNSS Bazë–Rover, 4 ditë për Total Station, 4 ditë për dronin me RTK dhe 1 ditë për Detektuesin Metal/Gize, duke siguruar që stafi të zotërojë njohuritë dhe aftësitë për përdorim të saktë dhe efikas të pajisjeve gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

Ky kriter teknik është proporcional dhe i lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit, duke garantuar që furnizimi, instalimi dhe përdorimi i pajisjeve të kryhet në mënyrë të saktë, të sigurt dhe me cilësi të lartë, duke minimizuar rreziqet teknike, dhe duke siguruar që investimi publik të realizohet me efikasitet maksimal.

Specifikimet teknike përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që e vlerëson mallin si të pranueshëm për funksionet e kërkuara si dhe është në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

NJËSIA E PROKURIMIT